

GJYKIMET PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

KORRIK - DHJETOR 2023

PËRMBAJTJA

GJYKIMET NË PROCEDURËN
PARAPRAKE

GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË
(SHQYRTIMI KRYESOR)

PROCEDURA NË SHKALLËN E
DYTË - GJYKATA E AELIT

PROCEDURA NË SHKALLËN E
TRETË - GJYKATA SUPREME

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) në vazhdimësi i monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK). Publikon buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara, të cilat i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informatat e përgjithshme mbi ecurinë e gjykimeve para DHSK përgjatë periudhës gjashtë mujore korrik - dhjetor të vitit 2023.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar shtatë (7) raste: Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve; Prokurori kundër Pjetër Shalës; Prokurori kundër Salih Mustafës; Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt; Prokurori kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit; Prokurori kundër Isni Kilaj; dhe Prokurori kundër Haxhi Shalës.

Që nga buletini i fundit i publikuar për peridhën janar-gershor 2023, para kësaj gjykate janë ngritur edhe dy (2) aktakuza të reja për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike dhe një (1) person tjetër është arrestuar dhe gjendet në paraburgim lidhur me dyshimin e pengimit të administrimit të drejtësisë, në këtë rast hetimet ende janë duke vazhduar.



GJYKIMET NË PROCEDURËN PARAPRAKE

Prokurori kundër Sabit Januzit & Ismet Bahtijarit

Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari akuzohen nga Prokurori i Specializuar për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Aktakuza e tyre u konfirmua më 2 tetor 2023 dhe u bë publike më 6 tetor 2023. Të akuzuarit u arrestuan në datën 5 tetor 2023 dhe u transferuan në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës një ditë më vonë. Të njëjtit akuzohen në dy pika për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (pika 1 dhe 2) si dhe në një pikë për frikësim gjatë procedurave penale (pika 3). Sipas aktakuzës së konfirmuar, veprat penale kanë ndodhur midis 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, ku të akuzuarit u takuan secili më vete me 'Dëshmitarin 1' për ta nxitur atë që të tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi fare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku këtë ata e bënë përmes përdorimit të kërcënimit të rëndë. Sipas aktakuzës, ata poashtu vepruan ndërkohë edhe në bashkëkryerje me individë të tjerë, me synimin për të frikësuar 'Dëshmitarin 1' dhe poashtu pengimin e prokurorëve dhe hetuesve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, në kryerjen e detyrave zyrtare.

Të akuzuarit janë paraqitur për herë të parë para gjyqtarit të procedurës paraprake të DHSK-së në datën 9 tetor 2023, ku njëkohësisht u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha pikat e aktakuzës.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në këtë rast është mbajtur edhe një konferencë për ecurinë çështjes, në të cilën palët kanë pasur mundësi të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre më lidhje me ecurinë e çështjes: qasjen në dokumentacion nga ana e mbrojtjes, çështjen e paraburgimit, dhe çështje të tjera teknike se si do të procedohet në vazhdimësi.

Prokurori kundër Haxhi Shalës

Haxhi Shala akuzohet nga Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) për vepra penale kundër rendit publik dhe për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. I njëjti u arrestua në datën 11 dhjetor 2023 dhe u transferua në objektin e paraburgimit në Hagë. Sipas aktakuzës së konfirmuar në datën 4 dhjetor, Haxhi Shala akuzohet për dy akuza të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (pika 1 dhe 2) si dhe për një akuzë të frikësimit gjatë procedurave penale (pika 3).

Sipas kësaj aktakuzë, midis periudhës 5 dhe 12 prill 2023, i pandehuri në bashkëkryerje me individë të tjerë, ndër të cilët Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari, u bashkërenduan si grup para dhe pas kontakteve personale të Januzit dhe Bahtijarit me 'Dëshmitarin 1'. Shala poashtu akuzohet se përmes udhëzimit të tij, Januzi dhe Bahtijari u takuan secili me 'Dëshmitarin 1' në dy raste të veçanta për ta nxitur atë që të tërhiqte dëshminë ose të mos jepte dëshmi fare para ZPS-së apo DHSK-së.

Pas arrestimit të tij, Haxhi Shala u paraqit për herë të parë para gjyqtarit të procedurës paraprake në datën 13 dhjetor 2023. Gjatë kësaj periudhe, në këtë rast është mbajtur edhe një konferencë mbi ecurinë e çështjes në datën 15 dhjetor, në të cilën Haxhi Shala u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

Prokuroria kërkoi që të bashkohen procedurat në çështjen kundër Haxhi Shalës dhe çështjen kundër Januzit dhe Bahtijarit në një gjykim të vetëm. Gjyqtari i procedurës paraprake dha urdhër me gojë më 14 dhjetor 2023 me të cilin urdhëroi prokurorinë të dorëzonte aktakuzën e përbashkët të propozuar deri në datën 12 janar 2024.

Prokurori kundër Isni Kilajt

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e ka arrestuar të pandehurin Isni Kilaj në datën 2 nëntor 2023. I njëjti është arrestuar mbi dyshimin se ka kryer vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Kilaj u paraqit për herë të parë para DHSK në datën 4 nëntor 2023.

Më pas, brenda 48 orësh, gjykatësi i procedurës paraprake ka vendosur që i njëjti të vazhdojë mbajtjen e paraburgimit, për shkak të konstatimit se ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ekziston rreziku që i pandehuri të largohet nga vendi, të pengojë ecurinë e procedimit penal apo të kryejë vepra të mëtejshme.

Hetimet kundër Isni Kilaj ende janë duke vazhduar dhe deri në përfundim të muajit dhjetor 2023 ZPS nuk ka ngritur ndonjë aktakuzë.

GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË (SHQYRTIMI KRYESOR)

Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të gjithë me pozita të larta në UÇK, akuzohen nga Prokuroria për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit, për periudhën prej marsit të vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999, në disa lokacione në Kosovë dhe në Shqipëri, të cilat pretendohet të jenë kryer nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime. Të gjithë të akuzuarit gjenden në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020.

Procedura paraprake në këtë çështje ka zgjatur rreth dy vite e gjysmë. Në fillim të muajit prill të vitit 2023 ka filluar shqyrtimi kryesor me paraqitjen e fjalëve hyrëse të palëve në procedurë dhe që atëherë gjykimi ka vazhduar intenzivisht me dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria.

Gjatë periudhës korrik – dhjetor të vitit 2023 janë mbajtur gjithsej 50 seanca gjyqësore, ku janë dëgjuar 28 dëshmitarë të propozuar nga prokuroria.

Në mesin e këtyre dëshmitarëve 14 prej tyre kanë qenë dëshmitarë të mbrojtur, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë dhe dëshmitë e tyre janë mbajtur kryesisht në sesione private. Ndërkaq, 14 dëshmitarët e tjerë kanë dëshmuar me identitet të zbuluar për publikun. Në mesin e këtyre dëshmitarëve ka pasur dëshmitarë të cilët kanë qenë viktimë ose kanë pasur njohuri për ndonjë rast që ndërlidhet me aktakuzën, dhe të njëjtit kanë dëshmuar për strukturat komanduese të UÇK-së si dhe për qendrat e ndalimit në zona të caktuara.

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Pjetër Shala, pjesëtar i UÇK-së, akuzohet nga Prokuroria për krime të luftës për periudhën midis 17 majit të vitit 1999 dhe 5 qershorit të vitit 1999, kundër personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri. Pjetër Shala vazhdon të mbetet në paraburgim që nga arrestimi i tij në mars të vitit 2021.

Gjatë periudhës korrik – dhjetor të vitit 2023 janë mbajtur gjithsej 20 seanca gjyqësore, ku janë dëgjuar gjithsej dymbëdhjetë (12) dëshmitarë: një (1) dëshmitar i ZPS-së, dy (2) dëshmitarë të përfaqësueses së viktimave dhe nëntë (9) dëshmitarë të mbrojtjes.

Në muajin shtator të këtij viti mbrojtja filloi me dëgjimin e dëshmitarëve të mbrojtjes. Pothuajse të gjithë dëshmitarë kanë deklaruar pa masa mbrojtëse dhe pjesa dërrmuese e dëshmimeve të tyre janë mbajtur në seanca publike. Përmes dëshmitarëve të saj, mbrojtja ka paraqitur alibinë e të pandehurit për periudhën kritike të aktakuzës.

PROCEDURA NË SHKALLËN E DYTË – GJYKATA E APELIT

Prokurori kundër Salih Mustafës

Salih Mustafa, komandant i njësitit BIA të UÇK-së, është gjykuar për krimet e luftës, të cilat i ka kryer gjatë muajit prill të vitit 1999 në fshatin Zllash/Zlaš të Komunës së Prishtinës/Priştina.

Në datën 16 dhjetor të vitit 2022, Dhoma e shkallës së parë e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 26 vite burgim për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Në datën 6 prill të vitit 2023, trupi gjykues lëshoi urdhër për zhdëmtim të viktimave, ku kërkohet të paguhet shuma prej 207.000 € si kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të krimit.

Gjatë periudhës raportuese, kjo çështje ishte para Dhomës së Apelit dhe gjatë datave 26 dhe 27 tetor u mbajtën seancat e Apelit. Ndërkaq, në datën 14 dhjetor u mbajt shpallja e aktgjykimit të shkallës së dytë.

Kolegji i apelit i rrëzoi gati të gjitha pikat e ngritura në ankesën e parashtuar nga mbrojtja e Mustafës. Duke filluar nga epiteti i konfliktit jondërkombëtar, provat që janë përdorur në gjykim, ligjit më të favorshëm penal, deklaratat e dëshmitarëve, elementi i vrasjes së paligjshme, ndalimi arbitrar e deri te alibia. Pra, të gjitha ankesat e mbrojtjes janë rrëzuar, me përjashtim të pranimit të pjesërishëm të pikave 9F, 9H dhe 9K të dosjes së Apelit. Sipas kolegjit, shkelja e vetme në vendimin e shkallës së parë ka qenë lartësia e dënimit. Gjykata e Apelit e gjykoi të përshtatshme që dënimet individuale t'i ulën në dënime si vijon:

- Anulon dënimin me 10 vite dhe cakton dënimin 8 vite burgim për pikën 1 për ndalim arbitrar;
- Anulon dënimin me 22 vite dhe cakton dënimin 20 vite burgim për pikën 3 për torturë;
- Anulon dënimin me 25 vite dhe cakton 22 vjet burgim për pikën 4 të aktakuzës për vrasjen e paligjshme.

Në lidhje me këtë, kolegji caktoi dënimin unik prej 22 vjet burgim duke llogarit kohën e kaluar në paraburgim.

PROCEDURA NË SHKALLËN E TRETË – GJYKATA SUPREME

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë gjykuar për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Që nga arrestimi i të pandehurve në fund të shtatorit të vitit 2020, ndaj tyre ka qenë e caktuar masa e paraburgimit. Pas vendimit të shkallës së dytë, nga fillimi i shkurtit të vitit 2023 të pandehurit kanë qenë në vuajtje të dënimit.

Në datën 18 maj të vitit 2022, trupi gjykues i shpalli fajtorë të dy të akuzuarit për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe dënoi secilin të akuzuar me nga katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim.

Pas apelimit të vendimit të shkallës së parë nga mbrojtja e të pandehurve, Gjykata e Apelit në datën 2 shkurt të vitit 2023 e shpalli aktgjykimin dënues dhe i dënoi me katër (4) vjet e tre (3) muaj burgim. Ky është vendim i formës së prerë.

Në fillim të muajit maj të vitit 2023, mbrojtja e të pandehurve dorëzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme. Në datën 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

ULJA E DËNIMIT

Pas vuajtjes së 2/3 të dënimit dhe pranimit të informatave dhe mendimeve nga institucionet relevante lidhur me uljen e dënimit, në datën 12 tetor 2023, Kryetarja e DHSK vendosi të bëjë modifikimin e dënimit të z. Gucati dhe shqyrtimin e modifikimit të z. Haradinaj, përmes vendimeve të ndara për secilin prej tyre:

Për Hysni Gucatin vendosi të modifikojë dënimin për lirimin e tij më 18 tetor 2023 ose rreth kësaj date për arsyet si: shenja të rehabilitimit, gjasat e rishoqërizimit dhe riintegritit të suksesshëm, dhe peshës së veprave penale për të cilat personi është dënuar. Lirimi i të njëjtit është bërë në datën 17 tetor 2023 me kushtet e përcaktuara në vendim. Këto kushte duhet të plotësohen nga i pandehuri për pjesën e mbetur të dënimit prej katër vjet e tre muaj të shqiptuar nga Gjykata e Apelit, konkretisht deri në datën 24 dhjetor 2024.

Për Nasim Haradinaj vendosi të modifikojë dënimin për lirim të tij në datën 14 dhjetor ose rreth kësaj date, për arsyet: ka treguar shenja të distancimit nga veprat penale për të cilat u dënua, ka treguar disa shenja rehabilitimi, ka lidhje të forta familjare dhe shoqërore, që do të ndihmonin riintegrimin e tij në Kosovë. Lirimi i të njëjtit është bërë në datën 14 dhjetor 2023 me kushtet e përcaktuara në vendim, të cilat poashtu do të jenë në fuqi gjatë pjesës së mbetur të dënimit të dhënë nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

Disa prej kushteve të cilat duhet t'i përmbahen të dënuarit deri në përfundim të dënimit janë: mos largimi nga vendbanimi dhe shtetit të Kosovës pa leje të Administratës së DHSK, paraqitja në stacionin policor, dorëzimi i dokumenteve të udhëtimit, ndalimi i kontaktimit me dëshmitarë ose viktima (të mundshme) të DHSK, ndalimi i dhënies së deklaratave për televizione pa leje të Administratës së DHSK etj.

Gjetjet e FDHK:

-Gjatë periudhës raportuese korrik - dhjetor 2023 janë arrestuar katër (4) personat për pengimit të administrimit të drejtësisë apo ndikim në dëshminë e dëshmitarëve të prokurorisë për rastet të cilat lidhen me rastin kundër Thaqit dhe të tjerëve. Dëshmitarët nuk duhet të ndikohen nga persona të tretë dhe ata duhet të dëshmojnë lirshëm për ato çfarë kanë parë apo përjetuar. Veprime të tilla japin një mesazh jo të mirë se dëshmitarët ende nuk janë të sigurt që të japin dëshmi në rastet konkrete lidhur me veprat penale të krimeve të luftës apo krimeve kundër njerëzimit.

-Për dallim me gjashtëmujorin e parë, në gjashtëmujorin e dytë DHSK kanë qenë më transparente, pasi që seancat gjyqësore kanë qenë më të hapura për publikun. Kjo praktikë duhet të vazhdon sepse opinioni ka të drejtë t'i dëgjon deklaratat e dëshmitarëve por gjithnjë gjykata duhet të kujdeset që vetëm informata të cilat ndikojnë në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur të redaktohen dhe jo e tërë dëshmia e dëshmitarit.

-Politika ndëshkimore apo zbatimi i ligjit më të favorshëm penal me rastin e shqiptimit të dënimeve në rastet e krimeve të luftës është ende mjaft kritik dhe jo mjaftueshëm i qartësuar për opinionin dhe për juristët në Kosovë. Gjykata Supreme e DHSK duhet të jep një mendim juridik se pse Ligji Penal i RSFJ nuk zbatohet si ligji penal më i favorshëm me rastin e shqiptimit të dënimeve për veprat penale të krimeve të luftës, gjithnjë duke e pasur në konsideratë edhe Rregulloren e UNMIK 24/1999, pasi që ky ligj është aplikuar nga prokurorë dhe gjyqtarë të misionëve ndërkombëtare në Kosovë e po ashtu qëndrim të njëjtë e kanë edhe gjykatat vendore në Kosovë, se ligji më i favorshëm penal në rastet e krimeve të luftës në Kosovë është Ligji Penal i RSFJ-së.

-Institucionet e Kosovës duhet të gjejnë mekanizma dhe mënyrë që t'i kompensojnë të gjitha palët e dëmtuara pas përfundimit të rasteve gjyqësore, pasi kjo e drejtë është e garantuar me ligj dhe jo kompensimet e viktimave të mbeten vetëm në letër.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" nga organizata "National Endowment for Democracy" përmes projektit të quajtur "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës "National Endowment for Democracy".



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo